# KAM NJE LAJM BOMBE

## Nga Sebi Alla

### Eksplozivet dhe njerezit e pushtetit

Celulari qe u gjet mesditen e 13 gushtit 2005 ne makinen e kryekomisarit Xhavit Shala, nuk ishte per te komunikuar. Per hir te se vertetes, ai celular ishte destinuar per te cuar nje mesazh…shperthyes. I lidhur me nje sasi prej 200 gramesh eksplozivi plastik, te tmerrshmin C4, celulari-bombe u gjet rastesisht nga mekaniku i nje servisi ne lagjen “Spajkore” te Elbasanit, drejt te cilit Shala kish udhetuar nga Tirana per t’u bashkuar me familjen. Nevoja fatlume per te pire nje kafe u pasua nga ideja per t’i bere benzit nje kontroll te pergjithshem teknik, dhe dy rastesite shmangen nje shperthim qe do te ishte komentuar gjate. I pari qe dha kujen, qe mekaniku qe per pak sa nuk preku bomben, teksa futi duart ne motorinon e automjetit. Doli dylle i verdhe dhe lajmeroi te zotin, qe per momentin shtangu. Nuk kishte me detyra konkrete ne krye te ndonje drejtorie policie, por kallot qe kishte shkelur, do ta jepnin efektin e tyre. Megjithate, per fat te mire gjithcka u shmang: Pak muaj me vone do te akuzohej si ideator i atentatit, Aldo Bare, qe pritet te ekstradohet nga Turqia. Por me apo pa celulare, te tjera eksplozive kane shperthyer para e pas ketij rasti. Duke hedhur ne ere edhe gjurmet e autoreve te mundshem…………..

Deri me tani, eksplozivi me i perhapur eshte tritoli. Nje mall qe gjendej me shumice ne depot e armeve qe u shkermoqen ne vitin 1997. Por nese kjo lende tingellon “amatoreske”, bombat me celular qe vijne kryesisht nga Mali i Zi, kane gjetur treg ne vendin tone. Mendohet se ideatoret e armes se frikshme me eksploziv plastik jane ish-ushtarake te ushtrise serbe. Mjafton nje celular, C4 sipas deshires dhe disa fije telash per te prodhuar bomben sa artizanale, aq dhe moderne. Nje bombe qe po pervijon nje tendence “shperthyese”, mendimi edhe vetem i te ciles eshte tmerrues: Ja sesi mund te te heqin qafe, nese ke shkelur ne kallo te gabuara.

www.revistaklan.com/material.php?id=663

Klan

E perjavshme Informative




HOME

E Enjte, 25 Shtator 2008

KERKIM

KERKO NE ARKIV

GO

KERKO NE WEB

GO

Powered by ALBINDEX

RUBRIKAT

- Editoriali
- Aktualitet
- Drejt e ne teme
- Reportazh
- Ekonomi
- Opinion
- Interviste
- Ditari
- Flash Java
- KaneThene
- Lart_Poshte
- Ide

# Kam nje lajm bombe



**Pas demtimit te automjetit te deputetit te PS-se Erjon Brace, ngrihen alibite e para. Kamerat vertetojne se tritoli ishte vendosur kohe me pare. Autoret, anonime. Eksplozivet dhe njerezit e pushtetit**

**Sebi Alla**

Celulari qe u gjet mesditen e 13 gushtit 2005 ne makinen e kryekomisarit Xhavit Shala, nuk ishte per te komunikuar. Per hir te se vertetes, ai celular ishte destinuar per te cuar nje mesazh... shperthyes. I lidhur me nje sasi prej 200 gramesh eksplozivi plastik, te tmerrshmin C4, celulari-bombe u gjet rastesisht nga mekaniku i nje servisi ne lagjen "Spajkore" te Elbasanit, drejt te cilit Shala kish udhetuar nga Tirana per t'u bashkuar me familjen. Nevoja fatlume per te pire nje kafe u pasua nga ideja per t'i bere benzit nje kontroll te pergjithshem teknik, dhe dy rastesite shmangen nje shperthim qe do te ishte komentuar gjate. I pari qe dha kujen, qe mekaniku qe per pak sa nuk preku bomben, teksa futi duart ne motorinon e automjetit. Doli dylle i verdhe dhe lajmeroi te zotin, qe per momentin shtangu. Nuk kishte me detyra konkrete ne krye te ndonje drejtorie policie, por kallot qe kishte shkelur, do ta jepnin efektin e tyre. Megjithate, per fat te mire gjithcka u shmang: Pak muaj me vone do te akuzohej si ideator i atentatit, Aldo Bare, qe pritet te ekstradohet nga Turqia. Por me apo pa celulare, te tjera eksplozive kane shperthyer para e pas ketij rasti. Duke hedhur ne ere edhe gjurmet e autoreve te mundshem.